

DOKUMENTI KONSULTATIV

1. Për “Projektplanin e Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet, Baseni Lumor Ishëm”

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në kuadër të procesit të konsultimit për projektaktin “Projektplanin e Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet, Baseni Lumor Ishëm”, mirëpret mendimet, sugjerimet, komentet dhe propozimet nga qytetarët, ekspertët e fushës, nga të gjitha institucionet e interesuara, organizata jofitimprurëse etj.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimet në portalin e Regjistrimit Elektronik: 6 muaj, duke filluar nga data 9 tetor 2024

Si të përgjigjeni:

Kontributet që në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektaktit, do të përcillen nga qytetarët, ekspertët e fushës, nga të gjitha institucionet e interesuara, organizata jofitimprurëse, etj. Nëpërmjet:

- postës elektronike drejtuar Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, info@ambu.gov.al;
- me anë të regjistrimit elektronik në adresën <http://www.konsultimipublik.gov.al>;
- në adresën postare të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë;
- në adresën e email-it të koordinatorit për konsultimin publik irma.themeli@ambu.gov.al;
- në adresën e email-it të strukturës respektive në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, hermon.bonati@ambu.gov.al;
- nëpërmjet komenteve të drejtpërdrejta në tryezat e konsultimit të zhvilluara nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Kontakti:

Irma Themeli, Koordinatore për konsultimin publik në AMBU: irma.themeli@ambu.gov.al
Greis Dragoti, Koordinatore për të drejtën e informimit në AMBU: greis.dragoti@ambu.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

E-Konsultimi: në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” 6 muaj, duke filluar nga data 9 tetor 2024.

Tryeza konsultimi me grupet e interesit në nivel baseni lumor të cilat do të fillojnë të zhvillohen gjatë periudhës 6 mujore

Sfondi i propozimit legjislativ

Ky projektakt është hartuar mbështetur dhe në zbatim të ligjit nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar, dispozitave të ligjit nr. Ligj nr. 29/2024, datë 4.4.2024 “Për burimet ujore”, që hyn në fuqi në 25 tetor 2024, si edhe VKM-së nr. 1015, datë 16.12.2020, “Për Përmbajtjen, Zhvillimin dhe Zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore, të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore dhe Planeve të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet”.

Propozimet

Projektakti synon miratimin e një dokumenti i cili i shërben institucioneve shtetërore, enteve publike e private për të menaxhuar në mënyrë të harmonizuar riskun nga përmbytjet dhe marrjen e masave efektive, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e pasojave të mundshme negative nga përmbytjet për shëndetin e njeriut, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe aktivitetin ekonomik, në zonat respektive, me fokus arritjen e objektivave:

- a. Shmangia e risqeve të reja;
- b. Zvogëlimi i risqeve ekzistuese;
- c. Zvogëlimi i pasojave negative gjatë dhe pas një ngjarjeje përmbytjeje / forcimi i aftësisë ripërtëritëse;
- d. Përmirësimi i organizimit dhe kapaciteteve të menaxhimit të riskut nga përmbytjet, ndërgjegjësimi.

Pyetjet

Çështjet kryesore që mendojmë se duhet të diskutohen lidhur me këtë nismë janë:

- A janë identifikuar qartë dhe saktë objektivat specifike, të cilat synohen të arrihen me zbatimin e Planit?
- A mendoni se masat e përcaktuara në zbatim të këtij projektakti përmbushin qëllimet e tij dhe kontribuojnë në arritjen e objektivave?
- Si i vlerësoni mundësitë reale për zbatimin e masave të përcaktuara në projektakt?
- Si mendoni se janë rregulluar çështjet e lidhura me përdorimin e burimeve ujore?
- Si mendoni për përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesuara për zbatimin e këtij projektakti?
- A ka elementë të tjerë që duhet të përfshihen në projektakt?